

“**B**iblioDoc-Inn”: PROJEKTI ME I
RENDESISHEM PARTENARIAL ME
REGJI RAJONALE NE KUADRIN E
“KNOWLEDGE” TE PROGRAMIT INTERREG III A
ITALI-SHQIPERI

“BiblioDoc-Inn”: “Promovim dhe zhvillim i modeleve
novative të bashkëpunimit midis Bibliotekave dhe
Qendrave të dokumentimit italo-shqiptare”

REPORT FINAL
(2004-2008)

1. *Sintese përshkruese e tabelave*
2. *Falenderime*
3. *Galeri fotografish*
4. *DVD audio/video*

Projekti ka përfshirë n° 13 partnerë, ku n° 8 italianë e n° 5 shqiptarë, të koordinuar nga “Teca del Mediterraneo”- Biblioteka Multimediale & Qendër dokumentimi e Këshillit Rajonal të Puglia-s (PPL-Partner Project Leader).

Lista e n° 13 partnerëve: Teca del Mediterraneo-Biblioteka Multimediale e Qendër Dokumentimi e Këshillit Rajonal të Puglia-s (PPL), Kooperativa e shërbimeve kulturore NINIVE, Shoqata kulturore IRIDE, Junior Chamber Italiane, Infopoint Europa (nga viti 2005 e quajtur Europe Direct Puglia), Fondacioni Gramsci di Puglia, IPSAIC (Instituti Puglies për Historinë e Antifashizmit dhe të Italisë Bashkëkohore), AICCRE (Shoqata Italiane e Këshillave të Komunave dhe të Rajoneve të Europës)- Federata Puglia, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (deri në vitin 2005), Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (nga viti 2006), Arkivi Qëndror i Shtetit Shqiptar, Biblioteka publike “Qemal Baholli” Elbasan, Biblioteka publike “Marin Barleti” Shkodër.

Projekt me një kohëzgjatje katërvjeçare: nga viti 2004 në vitin 2007 (disa veprime të kufizuara janë zhvilluar gjatë vitit 2008).

Projekti pati një financim prej € 875.000,00.

Projekti është artikuluar në n° 5 linja aktiviteti, të cilat u kanë dhënë mundësinë n° 20 të rinjve shqiptarë të punojnë me instrumenta teknologjikisht të zhvilluar në sektorin e “knowledge” (njohurive) për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së projektit.

N° 5 linjat e aktivitetit janë mbështetur nga n° 2 veprime transversale, nën kujdesin e PPL: i pari i përket “publicitetit dhe komunikimit”, i dyti “monitorimit dhe rendikontit”.

Në kuadrin e veprimeve publicitare e komunikuese, është krijuar në website, nën kujdesin e PPL, një seksion web dedikuar projektit i pasuruar me n° 179 faqe XHTML e n° 380 files¹.

¹ E konsultueshem në gjuhën italiane në adresën: <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn-ita.htm> e në gjuhën shqipe: <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn-shq.htm>

Seksioni web i dedikuar Projektit është publikuar në muajin Prill 2004 si pjesë integrale e “Piazza Europa & Mediterraneo”, plataformë info-dokumentare e “Teca del Mediterraneo” dedikuar tematikave të marrëdhënieve kulturore transkufitare në brendësi të gjirit të Mesdheut dhe të përhapjes së tematikave komunitare.

Të dhënat sasiore të seksionit web janë si më poshtë:

- Numri total i faqeve: 179
- Numri total i sub-seksioneve: 9
 - Të përgjithshme
 - News (artikulluar në vite)
 - Linja aktiviteti (n. 6)
 - Kërkim
- Numri i files me përmbajtje (përfshijë materialet fotografike): 380

NEN-SEKSIONE	N° FILES	Shënime
PERMABJTJE TE PERGJITHSHME	54	Pëmban dokumenta drejtimi, materiale të projektit, programe dhe aktivitete
LINJA AKTIVITETI		
<i>New Public Management</i>	70	
<i>Infopoint Europa</i>	8	
<i>Çmimi Best Practice</i>	28	
<i>Buletinë tematikë dhe cikle diskutimesh</i>	86	Pëmban buletinë e kumtesa
<i>Karta të arkivit</i>	2	
<i>Komunikim e informacion</i>	10	
	204	
AUDIO/VIDEO	2	
TE DHENA E PERMBLEDHJE	120	
TOTALI	380	Përfshirë përkthimet

Materialet që nuk bëjnë pjesë në linjat e aktivitetit (54 dokumenta) është i përbërë nga përmbajtje të përgjithshme (jospecifikë): kumtesa, programe e dokumenta të projektit.

Seksioni është i artikuluar në dy pjesë gjuhësore, me një modalitet konsultimi që lejon kalimin nga një nën seksion në tjetrin, duke përdorur etiketat anësore lidhëse (të pranishme në çdo pjesë të seksionit web), me shenjë flamurin e dy vendeve.

Për të vazhduar me një kujdes të shumëvjetëshëm që TdM rezervon për temën e universalitetit të aksesit, seksioni web është projektuar në mënyrë të tillë për të garantuar kushtet e një navigimi “*device independent*”, duke kërkuar të favorizojë mënyra aksesit alternative për të plotësuar nevojat e përdoruesve edhe të atyre me aftësi fizike të kufizuara.

Seksioni web është projektuar duke ndjekur sa më shumë të jetë e mundur aderencën me linjat guidë të vendosura nga World Wide Web Consortium (o W3C), për redaktimin e përmbajtjeve: në momentin e projektimit këto përbëheshin nga WCAG (Web Content Accessibility Guidelines) 1.0 (1999), të artikulluar në 14 koncepte kyçe dhe 65 checkpoints, të shpërndarë në bazë të 3 prioriteteve. Për çdo pikë kontrolli shoqërohen teknika specifike, të grumbulluara në

Gjithashtu janë shpërndarë në version dygjuhësh totem, dépliant e disa dokumenta plotësues në kasetë VHS e DVD me përmbajtje prezantimin e projektit dhe të partnerëve.

Ndër veprimet komunikuese përmendim dhe konferencat e shtypit të zhvilluara, duke filluar nga ajo e prezantimit të projektit e mbajtur tek Biblioteka Kombëtare në Tiranë më 7 Maj 2004 dhe në Hotel Villa Romanazzi Carducci në Bari më 18 Qershor 2004, si dhe pajisja e një pike-antene pranë Pallatit të Kulturës në Tiranë dhe pjesëmarrja e staff-it të projektit në aktivitete të ndryshme, ekspozita e sallone, përmendim këtu ditët Puglia-Shqipëri në Tiranë (13-14 Dhjetor 2006), Fiera del Levante në Bari (edicionë të ndryshme), salloni "COMP.A" në Bologna (3 Nëntor 2004).

Në kuadër të veprimeve të monitorimit dhe të rendikontit janë prodhuar disa reports të avancimit financiar me kërkesat specifike të B.E.-s si dhe ky report dygjuhësh i monitorimit final i përbërë nga tekste informative, tabela, news, fotografi dhe një DVD audio/video.

dokumenta mbështetëse për çdo kuadër aplikimi ("HTML Techniques", "CSS Techniques", "Techniques For Accessibility Evaluation And Repair Tools" e kështu me radhë).

Objektivi i ofrimit të itinerareve dhe modaliteteve alternative për përdorimin e informacionit është realizuar nëpërmjet përdorimit të shkurtimeve të itinerarëve të ndryshëm (navigim kryesor, tregues konteksti, grupe informacioni), duke u dhënë elementëve tekstualë dhe ipertekstualë një kuptim konsistent dhe univok (dmth jo e bazuar në referime visive ose tekstuali të përafërt), duke seleksionuar në nivele hierarkike informacionin e shpërndarë në faqen: me përdorimin e elementëve *headers*, nëpërmjet listave (të elementëve, të link të brendshëm ose të jashtëm), duke vendosur një raport midis rreshtave dhe kolonave të një tabele.

Kjo ka bërë që faqja të jetë më e përdorur nga motorët e kërkimit, që punojnë në grilën strukturale për të përcaktuar rëndësinë e informacionit të përmbajtur. Nëpërmjet një përdorimi të përshtatur të niveleve, përdoruesit e teknologjive të asistueshme mund të përfitojnë nga lidhje më të shpejta me nën-seksione të ndryshme duke lehtësuar kështu navigimin. Edhe duke përdorur një modalitet të aksesit linear si audio, në seksionin web rezulton i mundshëm të hysh në brendësi të faqes dhe të marrësh një ide të shpejtë rreth përmbajtjeve, operacione këto të pamundura pa ndihmës vizivë.

Gjithashtu për të garantuar koordinimin e linjave të aktivitetit dhe një pjesëmarrje të gjerë sidomos të bibliotekarëve shqiptarë, në fund të çdo viti janë zhvilluar n° 4 meetings trans-aktivitete.

Para se të prezantojmë në detaje çfarë është realizuar, po sjellim një refleksion të shkurtër rreth Ballkanit të Waldemaro Morgese, PPL i Projektit dhe një koment të Elio Borgonovi, Profesor i Ekonomisë së ndërmarrjeve dhe administratave publike në Universitetin Bocconi të Milano-s, përsa i përket Raportit të dytë rreth Bibliotekave publike të Enteve lokale në Shqipëri (linja e aktivitetit rreth NPM).

“Disa autorë kujtojnë që termi “kohezion” do të thotë përkatësisht “aftësi e trupave për të rezistuar ndaj çdo veprimi që synon t’i copëtojë”.

Ky saktësim kurioz na duket interesant për të formuluar një bilanc të eksperiencës së krijuar nga “Teca del Mediterraneo” si “partner leader” i projektit Interreg IIIA Italia-Albania “BiblioDoc-Inn”, i cili ka promovuar bashkëpunimin italo-shqiptar ndër strukturat bibliotekare e dokumentale.

Në fakt, problemi i vërtet që duam të trajtojmë përsa i përket fqinjëve ballkanikë shqiptarë, nuk është krijimi i marrëdhënieve të reja por ruajtja dhe zhvillimi i lidhjeve të konsoliduara gjatë shekujve, për të evituar që ky popull i Adriatikut të zgjedhë skenare të tjera gjeo-politike jo vetëm përsa i përket transazioneve ekonomike, - por ajo çka është më e rëndësishme – për modelet vlerësuese, procedurat vepruese, qëndrimet social-kulturore.

Ky kontest konsiderimesh na bën të mendojmë që mund të egzistojë në bregun tjetër të Detit Adriatik një zonë e ngushtë vertikale me drejtimin Veri-Jug për t’u konsideruar “në kohezion” me Italinë; një zonë tipike “mesdhetare”, në gjendje të përforcojë akoma më shumë thelbin që historikisht ka krijuar Bashkimin Evropian aktual.

Kjo mënyrë e këndvështrimit ka shumë avantazhe edhe të tipit operativ, por mbi të gjitha duhet të na ndihmojë të kuptojmë – në kontekstin e nevojës për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhënie shumëshkullore – vlerën thelbësore që i duhet dhënë politikave të vlerësimit të “njohurive” (knowledge), një “kapital jomaterial” për të

cilin, në mirëkuptim me André Gorz, nuk është shumë e përshtatshme pyetja “sa vlen?”, por “çfarë vlen?”.

Veç të tjerash me termin “njohuri”, interpretim ky i miratuar nga të gjithë, i referohemi si njohurive individuale si kapacitet praktik (di të bëj) ose kapacitet spekulativ di të mendoj), ashtu dhe njohurive kolektive ose më saktësisht “dijeve” që përqëndrohen në organizata ose në kontekste ambientale të përcaktuara.

Duke e sofistikuar akoma më shumë linjën e gjykimit, mendojmë se mund të formulojmë një pikë të parë fikse, të ndihmuar nga disa shprehje të vlefshme për kë beson në prespektivën e një “welfare” jo shtetëror, por civil.

Duke iu referuar sintaksës tashmë të konsoliduar “Ekonomia Civile”, e cila në Itali u jep emër përpjekjeve afashinante të Luigino Bruni e Stefano Zamagni, mendojmë se Italia duhet të investojë më tepër në Vendet ballkanike, në kapital jomaterial të tipit të “njohurive” me synim konsolidimin e një “rajoni trans-adriatik italo-ballkanik”, nëpërmjet ripërtëritjes së identitetit të krijuar në shekuj (edhe pse – për një periudhë të shkurtër – i anuluar gjatë fazës së pushtimit fashist dhe gjatë eksperiencës së socializmit real), modernizimit, novacionit dhe fertilizimit me ndihmën e politikave welfare jo shtetërore: domethënë të bazuara në idenë që shoqërisë civile i duhet njohur aspirimi për t’u bërë protagonistë aktive jo vetëm të proceseve operative ose të programimit të ndërhyrjeve, por edhe të adoptimit të zgjedhjeve strategjike.

Ky marsh, në të njëjtin drejtim me procesin e realizimit të kandidaturës së Republikës së Shqipërisë si anëtare e B.E. dhe me pritjen e hyrjes së saj në familjen evropiane, do të lehtësonte transformimin cilësor të marrëdhënieve nga lidhje partenariale në lidhje “fqinjësie” (prossimità).

Sigurisht ato organizime të çuditshme me synim përmbledhjen, konservimin dhe bërjen të njohur të instrumentave fizikë në të cilët “regjistrohen” simbolet që zëvendësojnë komunikimin gojor (d.m.th. bibliotekat, që përmbledhin “dokumentat”) janë pjesë integruese ose më saktë majë diamanti e modeleve të “welfare mix”; sot, veç të tjerash, për shkak të zhvillimit teknologjik, karakterizohen gjithnjë e më shumë, në mënyrë novative, si “komunitet hibrid”, ashtu siç i ka përcaktuar Chris Rusbridge, kombinime të bibliotekave tradicionale (të bazuara në instrumenta analogjistik) dhe të bibliotekave virtuale (të bazuara në instrumenta digjitalë).

Bibliotekat janë sigurisht një nga kolonat e shumta mbi të cilat mund të ndërtohen politikat e “welfare”. Një bast i hapur është shndërrimi i bibliotekave në themele të welfare “civile”: në këtë front të avancuar projekti Interreg IIIA “BiblioDoc-Inn” ka krijuar një eksperiencë shumë domethënëse, me realizime konkrete, të përbëra nga aktivitete tekniko-shkencore për të përhapur vlerat e efijencës, efikasitetit dhe cilësisë së aktivitetit publik, të ceremonive në të cilat është përforcuar dialogu zyrtar, të të mirave dhe shërbimeve dokumentare të prodhuara për interes të përbashkët, të

“award” për të vlerësuar në mënyrë sociale praktikat pozitive, të trajnim/informimit rreth Evropës, të rekuperimeve dhe vlerësimeve arkivuese të nevojshme për të hapur dritare të reja rreth çështjeve historike me interes të përbashkët.””

Waldemaro Morgese

“”Vështirësitë e proçeseve të tranzicionit të Vendeve nga një model politiko-institucional dhe ekonomik në një model tjetër, janë evedentuar më së miri në raportin e dytë rreth sistemit bibliotekar shqiptar. Në fakt, në këto periudha duhen rikrijuar disa elementë bazë të shoqërisë e në të njëjtën kohë duhet ndjekur evolucioni që manifestohet në nivelin e komunitetit ndërkombëtar. Raporti në kompleks evidenton natyrën dhe kompleksitetin e sfidave që sistemi bibliotekar shqiptar duhet të përballojë gjatë këtyre viteve. Analizimi, nis nga konsiderata që në situata të tilla është e kotë të kërkohen shkaqet ose përgjegjësit e vështirësive aktuale dhe është më mirë të përqendrohet vëmendja në ndërhyrjet për përmirësimin me nivel më të lartë fatibiliteti d.m.th. realisht të mundshme. Mënyrat e interpretimit të raportit mund të përcaktohen në termat e mëposhtëm.

Organizimi korrekt i studimit, që nuk është kryer nga ndonjë grup ekspertësh të huaj por ka përfshirë përgjegjësit kryesorë të sistemit bibliotekar shqiptar, të cilët kanë qënë në gjendje të përcaktojnë problemet reale dhe konkrete. Ky qëndrim i ka lejuar partnerit italian, Biblioteka Multimediale e Qendër Dokumentimi pranë Keshillit Rajonal të Puglia-s, të vëjë në dispozicion kompetencat e veta për të stimuluar përgjegjësit e sistemit shqiptar për të analizuar në mënyrë sistematike problemet, për t’u sintetizuar më mirë për të përpunuar sygjerimet për përmirësim. Këto sygjerime, duke qënë se i referohen kontekstit specifik do të jenë të nevojshëm për organet që mund të marrin vendime e të realizojnë politikat dhe ndërhyrjet e nevojshme. Linjat e ndërhyrjes të ndërtruara në bazë të kërkesave, janë të personalizuar dhe kontekstuale me realitetin specifik e nuk shfaqen modele “të rëna me parashutë” nga jashtë me përshtatje marxhinale siç ka ndodhur shpesh.

I nevojshëm shfaqet vëmendja ndaj historisë që kujton funksionin që bibliotekat në Shqipëri duhet të luajnë në këtë fazë, roli i përhapjes në mënyrë kapilare në popull të kulturës dhe njohurive të origjinës së vet. Sintetik, preçiz dhe esencial është përshkrimi i sistemit bibliotekar që vë në dukje nga njëra anë përmasat e kufizuara, përveç Bibliotekës Kombëtare, vetëm 4 biblioteka zotërojnë me tepër se 200.000 volume dhe 5 zotërojnë më tepër se 100.000 volume, dhe nga ana tjetër copëzimin ekstrem.

Tentativat për të vënë në rrjet, edhe në nivel lokal, bibliotekat që i përkasin subjekteve të ndryshme janë të pakta dhe me efikasitet të ulët. Në këtë pikë duhet ndërhyrë me shpejtësi dhe me vendosmëri.

Edhe pse në përgjithësi drejtimi i bibliotekave shfaqet tradicional dhe me personel akoma të patrajnuar për një funksion aktiv, duhet nënvijëzuar disa eksperiencia novative dhe sipërmarrëse, si shërbimi book mobile e bibliobus, nëpërmjet të cilit, edhe pse në mënyrë akoma artizanale dhe që i kalon iniciativat bibliotekave të

veçanta, kërkon të çojë librat nëpër shtëpitë e banimit për të stimuluar dëshirën për të studiuar. Duke menduar vështirësitë e transportit të cilat nuk u lejojnë shumë personave të hyjnë në bibliotekat që ndodhen larg banesave të tyre, këto shërbime bëhen akoma më shumë domethënëse. Janë akoma të pakta dhe me burime financiare e njerëzore të mangëta bibliotekat e pajisura me internet, me faqe web dhe në përgjithësi me katalogacion të informatizuar shumë të nevojshëm të gjithë këta instrumenta që mundësojnë realizimin e sinergjive me sistemet bibliotekare më të evoluara. Sigurisht në Vënd janë më të shumtë në numër internet point dhe përdorimi personal i internetit. Kështu mund të thuhet që në aspektin teknologjik nevojat kolektive, në rastin specifik të përhapjes së kulturës, kanë kaluar në plan të dytë në krahasim me nevojat individuale, mbi të gjitha për aktivitetin ekonomik.

Një tjetër aspekt që del në pah nga Raporti është impenjimi në dy fronte:

- Impenjimi për të rikrijuar dhe pasuruar dhurimin e librave, revistave, publikimeve në gjuhën shqipe (ndihmë kjo në rekuperimin e identitetit kombëtar);

- Impenjimi në pasurimin e shpejtë të Vëndit me publikime ndërkombëtare (sidomos në gjuhën angleze) rreth disiplinave për të cilat egzistojnë pak njohuri.

Shqiptarët që mund të kompletojnë studimet e tyre jashtë Vëndit janë në gjendje të ecin në të njëjtin hap me dinamikat ndërkombëtare. Por për të zhvilluar në mënyrë sostenibile një Vënd, nuk mjafton vetëm kaq, por duhet garantuar aksesin në njohuritë shkencore e në kulturën e avancuar (edhe nëpërmjet bibliotekave) i një numri sa më të lartë të mundshëm të popullsisë.

Të rëndësishëm janë kontributet e bashkëpunimit ndërkombëtar: në Report citohen ndërhyrjet e Bankës Botërore dhe të projekteve të tjera, si dhe dhurimi i 40.000 volumeve nga ana e Fondacionit SOROS. Edhe pse të gjitha këto ndërhyrje shfaqen jo gjithmonë të koordinuara e prandaj kanë një efikasitet të kufizuar. Dobësia dhe vështirësitë e mëdha të sistemit bibliotekar janë të evidentueshme nga informacionet e mëposhtme të pranishme në Report:

- Vetëm në 1995 është përkthyer në shqip dhe i është shpërndarë drejtuesve të bibliotekave sistemi i katalogimit IFLA/UNESCO;

- Mesatarja e numrit të personelit në shumicën e bibliotekave (2-3 operatorë, përveç dhjetëra bibliotekave me më shumë se 100.000 volume) dhe turnover i fortë i drejtuesve që shkakton humbjen e njohurive të akumuluar në kohë me anë të eksperiencës;

- vetëm në 2003 ka filluar aktivitetin Shkolla Kombëtare e biblioekonomisë për të përgatitur personel më të kualifikuar dhe me kopetencë të nevojshme për të ofruar shërbime sipas standards ndërkombëtarë.

Treguesit për të krijuar një sistem të vërtet bibliotekash në Shqipëri janë plotësisht të pranueshëm:

- *në nivel institucional, është kusht thelbësor një reformë organike për t'i dhënë një rol specifik tipeve të ndryshme të bibliotekave dhe të subjekteve të ndryshme që i drejtojnë;*
- *rritja e financimit do të tregojë që zhvillimi i njohurive shkencore njerëzore vlerësohen si një prioritet i Vendit;*
- *përfërcimi i dukshëm i bashkëpunimit si me Vendet e zonës (ku pengesë janë marrëdhëniet e vështira politike në Ballkan) ashtu dhe në nivel evropian e ekstraevropian.*

Po shtoj këtu, ose më saktë po specifikoj disa tregues metodologjikë. Në fakt sheshherë dihet çfarë duhet bërë, por është e vështirë të përcaktohen mënyrat më të mira dhe më efektive. Për t'i realizuar është e nevojshme të:

- a) *promovohet dhe të fuqizohet nëse egziston në plan formal një “Programi sistemi i bibliotekave” për t’u menaxhuar me logjikën dhe metodologjinë e project management: në nivel qendror dhe në nivel të decentralizuar për zona të ndryshme territoriale duhen përcaktuar objektivat, veprimet, koha, bashkëpunimet për t’u aktivuar, burimet e disponueshme ose për t’u gjetur;*
- b) *për projektin dhe për nën projektet e zonave territoriale duhen përcaktuar: një ose një grup drejtuesish: ata duhet të vlerësohen në bazë të rezultateve të arritura, e jo vetëm në bazë të koherencës dhe të cilësisë së programeve që zakonisht prezantohen në terma pozitivë;*
- c) *krijimi, fuqizimi, ose funksionimi në mënyrë më efektive sesa shfaqet në Report (nëse egziston) një Qendër kombëtare për të koordinuar ndërhyrjet e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me sistemin bibliotekar: nuk duhet të jetë një organ në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, që rrezikon të bëhet “filtër burokratik” dhe fren ndërhyrjesh që duhet të jenë fokusuar në objektiva specifike, por një organ të cilit i duhen drejtuar në mënyrë të vazhdueshme të gjitha informacionet në lidhje me projektet e ndryshme dhe mbi të gjitha sinjalizimi i shërbimeve novative të realizuara (best practices);*
- d) *një ndërhyrje thelbësore rreth teknologjive: që do të thotë përshpejtim i pajisjes me internet dhe me faqe web të bibliotekave, sigurisht duke zgjedhur një numër të kufizuar ndër bibliotekat më aktive dhe që kanë personel më të kualifikuar dhe më të motivuar: me katalogimin e*

automatizuar dhe me mundësinë për t'u lidhur në rrjet me bibliotekat, me bankat e të dhënave dhe me bankat e dokumentimit në brendësi të Vëndit dhe mbi të gjitha jashtë Vëndit, mundësohet rritja e aksesit në libra, revista, dokumenta zyrtarë e materiale të tjera.

Nga Report del në pah që sistemi bibliotekar shqiptar është në zhvillim, akoma i ngadaltë në krahasim me nevojat e shoqërisë për ndryshim dhe për hapje ndaj botës së jashtme dhe fjalët thelbësore për të bërë një hap cilësor në procesin e modernizimit janë: koordinimi, vënia në rrjet e bibliotekave egzistuese dhe të pasurisë së tyre, hyrja në rrjete ndërkombëtare, përhapje më të shpejtë të iniciativave që duken të kufizuara por që janë shumë efikase, si për shembull bibliobus. E së fundi, do të jetë e nevojshme të sigurohen fonde dhe dhurime ndërkombëtare rreth projekteve të qarta, specifike, në gjendje të krijojnë kushtet për të menaxhuar këto fonde me efikasitet dhe efçencë. Në fakt, gjithmon e më shumë në nivel ndërkombëtar subjektet (institucione ose privatë) të cilët vendosin në dispozicion fonde, kërkojnë dhe vlerësojnë kushtet që garantojnë një përdorim sa më të mirë të këtyre fondeve. Sigurisht financuesit e projekteve të bashkëpunimit për zhvillim në të gjitha fushat duan të evitojnë rrezikun e “hedhjes së burimeve në puse të reja shpërdorimi e joefçence”, ashtu si fátkeqësisht në të kaluarën janë vlerësuar ndërhyrje të shumta në shumë Vende.””

Elio Borgonovi

Po përshkruajmë çfarë është realizuar në lidhje me n° 5 linjat e aktivitetit dhe n° 4 meetings zhvilluar çdo fund viti.

1 . Linja e aktivitetit “Infopoint Europa”: nën kujdesin e partnerit italian “INFOPOINT EUROPA”, më pas i njohur me emrin “EUROPE DIRECT PUGLIA”, janë krijuar **n° 3 antena informative rreth B.E.** të quajtura “**Infopoint Europa**” pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (më pas, nga viti 2006, e spostuar pranë Bibliotekës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) dhe pranë Bibliotekave Publike të qyteteve Elbasan e Shkodër.

Për funksionimin e tyre u firmosën kontrata me **n° 6 të rinj shqiptarë** (n° 2 për çdo antenë) të cilët kanë punuar deri në fund të vitit 2006. “Infopoint Europa” janë pajisur me instrumenta informatikë, me lidhje interneti satelitare dhe me sw ndëraktive.

Për të rinjtë shqiptarë të impenjuar partneri italian “EUROPE DIRECT PUGLIA” ka aplikuar një *program trajnimi dhe aaxhornimi periodik* rreth tematikave të “front-office” dhe rreth politikave dhe mundësive të Bashkimit Evropian, organizuar në *n° 8 “stages”*, në publikimin e *n° 30 newsletters* e në kryerjen e testeve të vlerësimit. “Infopoint Europa” kanë organizuar në 2006 – vit i përfundimit të linjës së aktivitetit – aktivitete në qytetet përkatëse (n° 2 “info-days”, n° 1 turne sportiv, n° 1 konkurs rreth B.E.).

2. Linja e aktivitetit “Buletinë tematikë dygjuhësh”: n° 2 partnerë italianë (Kooperativa e Shërbimeve Kulturore “NINIVE”, Shoqata Kulturore “IRIDE”) e n° 3 partnerë shqiptarë (“BIBLIOTEKA PUBLIKE ELBASAN”, “BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODER”, “BIBLIOTEKA E AKADEMISE SE SHKENCAVE TE SHQIPERISE”) janë kujdesur për publikimin e *n° 5 buletinëve periodikë* me teste, dokumenta, skeda sintesë me argumenta të rëndësishëm, publikimet janë përkthyer edhe në gjuhën tjetër (ato shqiptare në italisht dhe në të kundërt), duke krijuar kështu buletinët “dygjuhësh” të organizuar në *n° 29 fascicoli* (14 të përpunuar nga partners pugliesë dhe 15 nga partners shqiptarë), të gjithë të disponueshëm për konsultim on line.

Rreth tematikave të trajtuara në buletinët dygjuhësh janë krijuar gjatë gjithë vitit 2007 “*cikle diskutimesh*”. Në Puglia është aktivuar një “cikël diskutimesh” me shkolla të ndryshme, i cili ka promovuar n° 4 seminare ndërkulturore dhe n° 16 module didaktike: ky cikël me bashkëpunimin edhe të Zyrës Arsimore Rajonale, është quajtur “*Shoku im i bangës, Shqipëria*”². Në

² Katër seminarët ndërkulturore janë zhvilluar në Bari (25/01/2006), Bari-Taranto-Foggia (12-15/02/2007), Bari (23/04/2007 me rastin e Ditës Botërore të Librit), Bari (15/05/2007). Të gjithë seminarët janë planifikuar në mirëkuptim me Universitetin e Bari-t Katedra e Pedagogjisë Ndërkulturore, me Zyrën e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Puglia-s e me mediatorët gjuhësorë-kulturorë. Seminarët janë ndjekur nga takime pune dhe nga analiza monitorimi dhe dorëzim të certifikatave të pjesëmarrjes. Aktivitetet përgatitëse janë të konsultueshme në italisht në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bdi-linea-boll.htm> e <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn-iniziative.htm> dhe në shqip në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bdi-linja-boll.htm> e <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn-iniziative-shq.htm>.

Shqipëri janë aktivuar dy “cikle diskutimesh” në Elbasan e Shkodër: janë zhvilluar seminare dhe takime të ndryshme me një total n° 25 aktivitete³.

Për të bërë më të larmishëm “ciklet e diskutimeve” PPL ka promovuar publikimin dygjuhësh, pranë një Shtëpie Botuese pugliese, të librit të shkrimtarit shqiptar Skënder Drini (*“Tregimet e Veriut” – I racconti del Nord*), përkthyer në italisht nga një mediatore shqiptare me asistencën e Katedrës së Albanologjisë së Universitetit në Salento⁴.

Volumi është prezantuar në shumë shkolla pugliese në praninë e autorit. Gjithashtu PPL ka favorizuar zhvillimin e binjakëzimeve midis shkollave italiane e shqiptare dhe ka promovuar më datë 13 Dhjetor 2007 një *tryezë të rrumbullakët rreth situatës së literaturës shqiptare pas viteve '90* me pjesëmarrjen e shkrimtarëve, botuesve, studiuesve italianë e shqiptarë.⁵

Në këtë linjë aktiviteti kanë punuar *n° 11 të rinj shqiptarë* në bazë të kontratave të firmosura, ku n° 2 mediatorë gjuhësorë.

3. Linja e aktivitetit “New Public Management”: rreth këtij argumenti janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, ku *n° 6 workshop teknike*, disa në Puglia të tjerë në Shqipëri, nën kujdesin e PPL “TECA DEL MEDITERRANEO”.

³ Aktivitetet e programuar në Elbasan i janë kushtuar Lef Nosit, historisë së Elbasanit, ndotjes së mjedisitvlerave të bibliotekës (me Manjola Hatellari), figurës së Aleksander Xhuvani, patriotit Sule Harri, festës tradicionale të verës, një konkursi të drejtuar studentëve se si të shkruajnë një pjesë muzikore, një ekspozitë fotosh nga nxënës, një leksion të Liman Varoshi rreth historisë, takime me shkrimtarët Astrit Bishqemi, Ylrije Kolla e Musa Vyshka, lufta kundër drogës në bashkëpunim me Qendrën Rinore Riemar, historia e bibliotekës Baholli, ilustrimi i gazetës Pasqyra e Diturisë, një takim me shkrimtaren Eva Prenga, një takim me Abdulla Ballhysa rreth komunikimit gjuhësor, një ekspozitë e literaturës kosovare, Rruga Egnatia, një takim rreth shkollës Normale Luigj Gurakuqi (e para e krijuar në Elbasan). Aktivitetet e programuara në Shkodër i janë kushtuar veprës së Skënder Drinit, kontributit të pedagogut Mati Logoraci, një takim rreth sforcimeve për unifikimin e gjuhës letrare shqiptare, artit dhe traditave të qytetit të Shkodrës, një takim me shkrimtarin për fëmijë Xhahid Bushati me rastin e ditës botërore të librit.

⁴ Përkthim, hyrje nën kujdesin e Pavlina Naska. Kontribut i Silvia Godelli e prezantim i Monica Genesin.

⁵ Në tryezën e rrumbullakët, e hapur nga Waldemaro Morgese e koordinuar nga Rosalba Magistro, kanë marrë pjesë: Shaqir Rexhvelaj (Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Artit, Rinisë dhe Sporteve të Ministrisë së Turizmit, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë), Skender Drini (shkrimtar), Besim Petrela (President i Shoqatës kulturore Syri Blu në Tiranë), Ridvam Dibra (shkrimtar), Monica Genesin (docent universitar), Gianni Belluscio (docent universitar), Giovanna Scianatico (docent universitar), Genc Lafë (docent universitar), Pavlina Naska (mediatore), Marjana Ymeri (drejtoreshë e bibliotekës), Petrit Ymeri (botues), Gjovalin Çuni (drejtor biblioteke), Giuseppe Ponticelli (botues), Livio Muci (botues).

Partneri shqiptar “BIBLIOTEKA E AKADEMISE SE SHKENCAVE TE SHQIPERISE” ka krijuar një *“Observator rreth praktikave pozitive të bibliotekave shqiptare të Enteve Lokale”*, që ka përpunuar dhe publikuar në 2006 e 2007 *n° 2 Raporte dygjuhëshe* prezantuar operatorëve dhe Autoriteteve.

*“Raporti i parë rreth Bibliotekave publike të Enteve lokale në Shqipëri”*⁶ u është prezantuar në Bari bibliotekarëve italianë dhe të zonës së Mesdheut, më datë 16 Qershor 2006 gjatë *1° meeting të Bibliotekave mesdhetare* promovuar nga Teca del Mediterraneo, i është dorëzuar zyrtarisht Zëvendës Ministrit të Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadorit të Italisë në një takim të posaçëm (Tiranë, 11 Korrik 2006), gjithashtu u është prezantuar dhe bibliotekarëve shqiptarë gjatë të tretit meeting ndëraktivor të projektit (Tiranë, 24 Nëntor 2006).

*“Raporti i dytë rreth Bibliotekave publike të Enteve lokale në Shqipëri”*⁷, i cili merr në studim gati 80% të bibliotekave shqiptare të Enteve Lokale, u është prezantuar në Bari bibliotekarëve italianë dhe të onës mesdhetare gjatë *meeting të dytë të Bibliotekave mesdhetare* promovuar nga Teca del Mediterraneo më 22 Qershor 2007, i është dorëzuar zyrtarisht në Tiranë Ministrit të Kulturës së Republikës së Shqipërisë më 24 Korrik 2007, i është prezantuar bibliotekarëve shqiptarë gjatë të katërtit meeting ndëraktivor të projektit (Tiranë, 16 Nëntor 2007).

Në kuadër të linjës së aktivitetit Partner Project Leader “TECA DEL MEDITERRANEO” ka përpunuar dhe publikuar në Faqen Web të projektit *n° 350 skeda bibliografike dygjuhëshe me abstracts* rreth fondeve të disponueshme pranë Bibliotekës Multimediale të Këshillit Rajonal të Puglia-s rreth tematikave të NPM, për t’u lejuar operatorëve italo-shqiptarë një axhornim

⁶ Raporti nën kujdesin e Marjana Ymeri në italisht i konsultueshëm në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn/doc/Bibliodocinn-Report-Biblioteche-albanesi-2005-ita.pdf> e në shqip në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn/doc/Bibliodocinn-Report-Biblioteche-albanesi-2005-shq.pdf>.

⁷ Raporti nën kujdesin e Marjana Ymeri e Tefta Buzo, në italisht i konsultueshëm në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn/doc/Bibliodocinn-Report-Biblioteche-albanesi-2006-ita.pdf> e në shqip në <http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn/doc/Bibliodocinn-Report-Biblioteche-albanesi-2006-shq.pdf>.

profesional sa më të mirë; veprat e përmendura në skeda mund të konsultohen “full text” nëpërmjet procedurave të thjeshtësuara të huasë ndërbibliotekore.

4. Linja e aktivitetit “Çmimi Best Practice”: partneri italian “JUNIOR CHAMBER ITALIANA” ka aktivuar në Shqipëri një testim publik për të vlerësuar çdo vit me çmim drejtorat e bibliotekave, të cilët janë dalluar për efikasitetin e tyre në drejtim në bazë të standards cilësorë.

Çmimet në euro u janë dhënë, *n° 4 drejtorave të bibliotekave shqiptare* gjatë n° 3 ceremonive të rëndësishme publike, më 17 Janar 2004 drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, më 23 Prill 2005 drejtoreshës së Bibliotekës Publike Fier, më 26 Maj 2006 “ex aequo” drejtoreshës së Bibliotekës Publike Vlorë dhe drejtoreshës së Bibliotekës Publike Durrës.

Ky çmim ka patur shumë prestigj ndër bibliotekarët shqiptarë.

5. Linja e aktivitetit “Vlerësim i arkivave me interes të përbashkët”: 3 partnerë italianë (“IPSAIC”, “FONDACIONI GRAMSCI DI PUGLIA”, “AICCRE PUGLIA”) dhe 1 partner shqiptar (“ARCHIVIO CENTRALE DI STATO D’ALBANIA”) kanë studiuar dhe vlerësuar *kartat e arkivit rreth marrëdhënieve politiko-sociale dhe kulturore midis Italisë (Puglia në veçanti) dhe Shqipërisë në periudhën 1907-1948*.

Kjo periudhë historike e zgjedhur i përket fazave shumë të rëndësishme të historisë së përbashkët të të dy popujve në vitet Nëntëqind, përfshirë historinë “ekonomike”. *N° 3 të rinj arkivues shqiptarë* të cilët kanë firmosur një kontratë me këtë linjë aktiviteti, arkivues të shumtë shqiptarë e italianë si dhe mësues e nëpunës janë impenjuar në Bari pranë Fakultetit të Shkencave Politike të Universitetit në *n° 2 “stages” trajnimi dhe informimi rreth B.E.* dhe rreth matricës së përbashkët mesdhetare, nën kujdesin e partnerit “AICCRE PUGLIA”: argumenti i të parit stage – zhvilluar më 13 e 14 Prill 2007 – ka qënë procesi i

integritet evropian, i të dytit stage – zhvilluar më 27 Shtator 2007 – e drejta e autorit dhe bibliotekat digjitale.⁸

Është publikuar volumi dygjuhësh *“Hebrejtë në Shqipëri – Guidë në burime”*, frut i bashkëpunimit të partner shqiptar “ARKIVI QENDROR I SHTETIT SHQIPTAR” me partners italianë “IPSAIC” e “FONDACION GRAMSCI DI PUGLIA”. Volumi është prezantuar në Bari më 24 Janar 2007, në Tiranë më 2 Prill 2007, në Torino më 12 Maj 2007 në kontekstin e Ekspozitës së XX-të Ndërkombëtare të Librit.¹⁰

Nën kujdesin e këtyre partnerëve është publikuar gjithashtu dhe volumi *“Puglia dhe Shqipëria në vitet Nëntëqind”* me studime origjinale rreth kartave të arkivit të vlerësuara¹¹ dhe është realizuar një *ekspozitë dygjuhëshe me n° 25 panele* rreth këtyre kartave, e pajisur dhe me një libër-katalog i titulluar *“Midis Puglia-s dhe Shqipërisë–marrëdhënie politiko sociale e kulturore 1907-1948”*, ekspozita është inaguruar në Tiranë më 16 Nëntor 2007 gjatë të katërtit meeting rreth projektit dhe është ekspozuar pranë Arkivit Qëndror të Republikës së Shqipërisë deri në datën 4 Janar 2008; më pas është inaguruar në Bari më 6 Mars 2008 pranë Këshillit Rajonal të Puglia-s, në praninë edhe të përfaqësuesve diplomatikë e të Medias, dhe e ekspozuar ndaj publikut nga 20 Mars deri më 30 Prill 2008 pranë “Teca del Mediterraneo”.

6 “Meetings çdo fundvit”

Në lidhje me n° 5 linjat e aktiviteteve specifike, koordinimi dhe sinergjia midis tyre është garantuar nga zhvillimi sistematik, në fund të çdo viti, të një meeting ndëraktivor, zhvilluar gjithmonë në Shqipëri: në total *n° 4 meetings për n° 7*

⁸ Në të dy stages kanë marrë pjesë 20 drejtues, funksionarë, arkivues e bibliotekarë të Administratave Publike shqiptare. Relatorët e seminareve të zhvilluar pranë Fakultetit të Shkencave Politike të Universitetit të Barit kanë qenë prof. Ennio Triggiani, prof. Valeria Di Comite dhe prof. Cosimo Notarstefano.

⁹ Nën kujdesin e Nevila Nika e Liliana Vorpsi.

¹⁰ Në Torino volumi është diskutuar nga historianët Luciano Boccalatte e Alberto Cavaglion, të Institutit Piemontes për Historinë e Rezistencës dhe të Shoqërisë Bashkëkohore.

¹¹ Nën kujdesin e Giulio Esposito, Vito Antonio Leuzzi, Nevila Nika. Ndër dokumentat e prezantuar tërheq vëmendjen një dorëshkrim, “Shënim historiko-politik i Shqipërisë”, i gjendur në Arkivin Qëndror të Shtetit në Tiranë, i cili evidenton rolin e Indro Montanelli, i dërguari special i “Corriere della Sera”, në përshkrimin dhe prezantimin e historisë së “Vendit të Shqiponjave”.

ditë punimesh, të zhvilluar më 17 Dhjetor 2004, më 11 e 12 Nëntor 2005, më 24 e 25 Nëntor 2006, më 15 e 16 Nëntor 2007.

Gjatë n° 7 ditë punimesh janë prononcuar *n° 48 kumtesa nga pala italiane* (ku n° 2 në formë video) dhe *n° 41 kumtesa nga pala shqiptare*, janë zhvilluar *n° 18 seksione seminaresh*, përveç n° 5 përshëndetjesh zyrtare të punimeve nga Autoritetet italo-shqiptare, catering, ceremoni të dhënies së çmimeve, inagurimi i një ekspozite dokumentare dhe një “galà” e rëndësishme liriko-sinfonike me titull “Muzikë e sinfoni euro-mesdhetare”: duke vlerësuar lidhjen e fortë midis dy popujve italian e shqiptar e krijuar nga Deti Mesdhe në “programin e sallës” të “galà” është paraqitur ky imazh i detit që bashkon dy brigjet.

Aktiviteti “*Muzikë e sinfoni euro-mesdhetare*” është zhvilluar në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit në Tiranë më 15 Nëntor 2007 me bashkëpunimin e Ambasadës Italiane, me kontributin organizativ të Institutit Italian të Kulturës në Tiranë dhe të sportelit informativ të Rajonit të Puglia-s në Tiranë; *ka regjistruar pjesëmarrjen e n° 1.000 spektatorëve*. Janë egzekutuar pjesë orkestrale të sinfonistëve shqiptarë (Gaqi, Zoraqi) dhe i muzikantëve italianë (Mascagni, Verdi, Puccini), të prezantuar nga studiues Zhani Ciko e Pierfranco Moliterni, drejtuar nga maestro Rino Marrone, të ndjekur nga orkestrantët e korit të Teatrit të Operas, nga tenori Agim Hushi e nga soprano Mara Monopoli. Koncerti është hapur me egzekutimin e himneve kombëtare italian e shqiptar dhe mbyllur me egzekutimin e himnit zyrtar të B.E. (“Himni i gëzimit” me muzikë të Van Beethoven e tekst të Schiller).

Theksojmë se tekstet e kumtesave gjatë n° 18 seksioneve seminaresh të meetings janë grumbulluar dhe shpërndarë pjesëmarrësve, përveç inserimit të tyre në faqen web të projektit për një konsultim universal e permanent.

Meetings të çdo fund viti kanë krijuar një impenjim të jashtëzakonshëm projektual-organizativ nga ana e stafit të “Bibliodocinn”, si dhe një shembull i rëndësishëm sesi është e

mundur të drejtohen në një linjë të vetme të gjitha aktivitetet e projektit, sesi mund të diskutohen kolektivisht jo vetëm ndërmjet operatorëve të projektit por ***në brendësi të një platëa shumë më të gjerë*** e për të përfshirë gjithashtu Autoritetet e dy Vendeve. Në fakt në n° 4 meetings kanë marrë pjesë shumë bibliotekarë përfaqësues të të gjitha bibliotekave publike më të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë dhe për të garantuar këtë lëvizje të rëndësishme të profesionistëve të “Knowledge” në n° 3 qytetet ku janë zhvilluar meetings (Tirana në katër vite, por edhe Shkodra në 2005 dhe Elbasani në 2006) është duhur një impenjim i madh operativ.

Efekti i n° 4 meetings ka qënë me rëndësi të madhe për vet bibliotekarët shqiptarë: në fakt sekuenca sistematike dhe e rregullt për n° 4 vjet, përfshirja e Autoriteteve, aktualiteti dhe interesi i shfaqur nga tematikat e trajtuara janë të një stimuli të lartë për ***auto-afirmimin e dinjitetit të profesionit të bibliotekarit dhe të ekspertit të dokumentimit*** dhe për të futur në axhendën politike shqiptare çështjen e zhvillimit të sistemit bibliotekar kombëtar e lokal pas ndodhive epokale të viteve ‘90.

Falenderime:

Teca del Mediterraneo (Partner Project Leader):

Stafi i koordinimit: Morgese Waldemaro (përgjegjë), Abenante Maria Antonietta, Ardillo Daniela, Magistro Rosalba, Vreshtazi Dhurata

Webmaster:

Perugino Vito

Kooperativa e shërbimeve kulturore “Ninive”:

Grimaldi Paola, Lovecchio Antonio

Shoqata kulturore “Iride”:

Di Pumpo Giusy, Lo Martire Daniela Annalisa, Mariani Dora

Junior Chamber Italiana:

Divella Rosa

Europe Direct Puglia:

Paolino Irene

Fondazioni Gramsci di Puglia:

Masella Luigi

IPSAIC-Instituti Puglies për Historinë e Antifashizmit dhe të Italisë Bashkëkohore:

Leuzzi Vito Antonio

AICCRE Puglia:

Triggiani Ennio

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë:

Plasari Aurel

Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

Ymeri Mariana

Arkivi Qëndror i Republikës së Shqipërisë:

Nika Nevila

Biblioteka Publike Elbasan:

Cankja Drita

Biblioteka Publike Shkodër:

Çuni Gjovalin

Universiteti i Barit:

Canaletti Fernando, Iaffaldano Nicolaia, Nisio Antonio

Shoqata e Bibliotekave Shqiptare (ALA):

Buzo Tefta

Sporteli informativ për bashkëpunim i Rajonit të Puglia-s në Tiranë:

Pinca Marilena

Falenderohen Autoritetet:

Berisha Lady Liri, consorte del Primo Ministro della Repubblica d'Albania

D'Elia Saba, Ambasciatore d'Italia in Albania

De Cristofaro Mario, Presidente Consiglio Regionale della Puglia

Godelli Silvia, Assessore al Mediterraneo Regione Puglia

Hasekiu Mimoza, Prefetto di Elbasan

Haxhi Artan, Sindaco di Shkodra

Iannucci Attilio Massimo, Ambasciatore d'Italia in Albania

Klosi Blendi, Ministro del turismo, cultura, gioventù e sport Repubblica d'Albania

Marguccio Stefano, Console d'Italia in Shkodra

Mineo Luciano, Vice presidente Consiglio Regionale della Puglia

Orlando Roberto, Console d'Italia in Shkodra

Palese Rocco, Assessore alla programmazione e bilancio Regione Puglia

Pango Ylli Vito, Ministro del turismo, cultura, gioventù e sport Repubblica d'Albania

Pepe Pietro, Presidente Consiglio Regionale della Puglia

Shkëmbi Rezar, console della Repubblica d'Albania in Bari

Turku Suzana, Vice ministro del turismo, cultura, gioventù e sport Repubblica d'Albania

Turku Ardian, Sindaco di Elbasan

Si ringraziano i signori:

Abbruzzese Angela, SMS “N.Pende” di Noicattaro
Akcal Ilhan, Biblioteca Nazionale della Turchia
Algieri Gianfranco, Europe Direct Puglia
Alija Admir, mediatore
Ancona Giovanni, Università degli Studi di Bari
Arianiti Tomorr, Scuola “Arianiti” di Elbasan
Aversa Mariangela, SMS “G.Galiei” di Monopoli
Baja Orjeta, Biblioteca Pubblica di Shkodra
Balbi Giovanni, Junior Chamber International
Bardhi Ornela, Biblioteca Pubblica di Elbasan
Barletta Nicoletta, SMS “G.Galiei” di Monopoli
Basha Athina, Biblioteca Pubblica di Fier
Basho Teresa, Infopoint Europa di Tirana
Begu Vitori, SCUOLA “J.Misja” di Shkodra
Belluscio Gianni, Università degli studi della Calabria
Bezhani Eda, Infopoint Europa di Tirana
Boccalatte Luciano, Istituto Piemontese per la Storia della
Resistenza e della Società Contemporanea
Boccardi Stefano, Gazzetta del Mezzogiorno
Bodeci Dhurata, Scuola “A.Agjahu” di Elbasan
Borgonovi Elio, Università “Bocconi” di Milano
Bosevski Mile, Biblioteca Nazionale di Macedonia
Botta Alfredo, Società Media Broadcast
Briganti Patrizia, ITC “P.Giannone” di Foggia
Bushati Salvatore, Accademia delle Scienze d’Albania
Butka Berta, Infopoint Europa di Tirana
Çala Arian, Associazione “Tjeter Vizion”
Calabrese Giuseppe, SMS “P.Pio” di Torremaggiore
Calabrese Luigi, Consiglio Regionale della Puglia
Calisi Annamaria, 1° Circolo didattico di Triggiano
Camassa Andrea, Società Media Broadcast
Cammarella Maria, Liceo Linguistico “M.Polo” di Bari
Cankja Oligerta, Biblioteca Pubblica di Elbasan
Carceneri Luciano, Biblioteca Nazionale di Bari
Cavaglion Alberto, Istituto Piemontese per la Storia della Resistenza e della Società
Contemporanea
Cavallo Silvana, Consiglio Regionale della Puglia
Ciani Adriano, Ambasciata d’Italia in Albania
Ciko Zhani, Teatro Nazionale dell’Opera e del Balletto di Tirana
Colecchia Luigi, Associazione ONLUS “Siamo in Teca”
Costa Christiana, Biblioteca Provinciale di Bari
Cozzi Michele, Consiglio Regionale della Puglia

Çuci Suela, Archivio Centrale di Stato d'Albania
Dashi Kujtim, Ministero del turismo, cultura, gioventù e sport Repubblica d'Albania
Dato Gino, Casa Editrice Progedit
De Bellis Maria, Regione Puglia
De Luigi Francesco Saverio, Ambasciata d'Italia in Albania
De Marzo Cinzia, Europe Direct Puglia
De Nicolo Teresa, Liceo Scientifico "Tedone" di Ruvo di P.
De Sanctis Maria Celeste, SMS "G.Bettolo" di Taranto
De Vito Gianluigi, Gazzetta del Mezzogiorno
Del Re Raffaella, IM "T.Fiore" di Terlizzi
De Palo Francesco, Società Media Broadcast
Dervisci Flora, Biblioteca Pubblica di Durres
De Santis Feliciano, Società Media Broadcast
Di Cagno Barbara, Consiglio Regionale della Puglia
Di Comite Valeria, Università degli Studi di Bari
Di Giovine Ludovico, Ufficio Scolastico Regionale per la Puglia
Di Nonno Annamaria, 3° Circolo Didattico "G.Mazzini" di Bari
Dibra Ridvan, scrittore
Djurovic Jelena, Biblioteca Nazionale del Montenegro
Domi Etleva, Biblioteca Nazionale d'Albania
Doronzio Franco, Società Media Broadcast
Drini Skender, scrittore
Entela Saiti, Infopoint Europa di Shkodra
Esposito Giulio, IPSAIC
Fornasari Alberto, Università degli Studi di Bari
Fortunato Licia, Associazione ONLUS "Siamo in Teca"
Genesin Monica, Università del Salento
Gjika Liljana, Biblioteca Pubblica di Vlore
Goffredo Rita, Ufficio Scolastico Regionale per la Puglia
Guri Blerta, mediatrice
Guri Shazie, Biblioteca Accademia delle Scienze d'Albania
Guxholli Kozeta, mediatrice
Habazaj Elona, Archivio Centrale di Stato d'Albania
Hajdëri Edmond, Università "Nostra Signora del Buon Consiglio" di Tirana
Hushi Agim, tenore
Iacobone Antonietta, 2° Circolo Didattico "S.Lorenzo" di Brindisi
Iannuzziello Marcello, Regione Puglia
Injac Luani, Scuola "B.Kadia" di Shkodra
Jashari Marsida, mediatrice
Kamarti Samia, Biblioteca Nazionale della Tunisia
Kita Adelina, Infopoint Europa di Elbasan
Kumbuli Aleksandra, mediatrice
Labbate Clara, Convitto Nazionale "R.Borghi" di Lucera
Laskaris Evangelia, Biblioteca Pubblica Centrale di Corfù

Lillo Francesco, Consiglio Regionale della Puglia
Lleshanaku Manjola, Biblioteca Pubblica di Elbasan
Maci Edison, Scuola “D.Bosco” di Shkodra
Maffei Concetta, ITIS “Pacinotti” di Taranto
Maggi Oronzo, Società Media Broadcast
Maffettone Sergio, Ambasciata d’Italia in Albania
Marrone Rino, direttore d’orchestra
Messore Valter, Consiglio Regionale della Puglia
Moliterni Pierfranco, Università degli Studi di Bari
Molloholli Drita, Scuola “J.Dilo” di Elbasan
Monopoli Mara, soprano
Morgese Giuseppe, Università degli Studi di Bari
Muci Livio, Casa Editrice Besa
Musaraj Elisabeta, mediatrice
Mussari Riccardo, Università degli Studi di Siena
Naim Ronya, Bibliotheca Alexandrina di Alessandria d’Egitto
Narazani Blerim, Casa della Cultura di Elbasan
Naska Pavlina, mediatrice linguistica
Natale Addolorata, Ufficio Scolastico Regionale per la Puglia
Notarangelo Bernardo, Regione Puglia
Notarstefano Cosimo, Polo Euromediterraneo “Jean Monnet”
Pansini Mariolina, Archivio di Stato di Bari
Paralloj Silvana, Scuola “D.Todri” di Elbasan
Parisi Natale, Fondazione Gramsci di Puglia
Pennella Giuseppe, C.A.I.MED-Centro per l’Innovazione Amministrativa nella
Regione Euro.Mediterranea
Peplekaj Arjan, Scuola “J.Dilo” di Elbasan
Petrela Besim, Associazione culturale “Syri Blu”
Plaia Pietro, Società Media Broadcast
Ponticelli Giuseppe, Casa Editrice Edizioni dal Sud
Popa Ylli, Accademia delle Scienze d’Albania
Porcelli Donata Rosaria, ITC “G.Cesare” di Bari
Qorri Shejnas, Scuola “Q.Guranjaku” di Elbasan
Quaranta Luigi, Corriere del Mezzogiorno
Quatera Isabella, 3° Circolo Didattico “G.Mazzini” di Bario
Rasetti Maria Stella, Biblioteca comunale di Empoli
Reci Lindita, Scuola “Peparimi” di Shkodra
Rexhvelaj Shaqir, Ministero turismo, cultura, gioventù e sport Repubblica d’Albania
Rusi Shpresa, Biblioteca pubblica di Shkodra
Sallaku Helga, Infopoint Europa di Shkodra
Schiavone Francesca Romana, Cooperativa di servizi culturali “Ninive”
Scianatico Giovanna, Università del Salento
Sejkati Violeta, mediatrice
Shahini Ana, mediatrice

Shennawy Hend, Bibliotheca Alexandrina di Alessandria d'Egitto
Shestani Dorotea, Scuola "M.Logoreci" di Shkodra
Shtjefni Gjergj, Infopoint Europa di Tirana
Sinani Steliana, Biblioteca Pubblica di Elbasan
Sinojmeri Gentiana, Archivio Centrale di Stato d'Albania
Sportelli Rita, Consiglio Regionale della Puglia
Stigliani Vito Antonio, Ambasciata d'Italia in Albania
Strippoli Francesco, Corriere del Mezzogiorno
Tahja Marsida, Biblioteca Pubblica di Shkodra
Taipi Miriam, Biblioteca Pubblica di Shkodra
Taipi Sadetin, Biblioteca Pubblica di Shkodra
Tarsitani Gaetano, Istituto Internazionale di Tirana
Tato Reita, Biblioteche Pubbliche di Tirana
Tedone Arcangelo, Consiglio Regionale della Puglia
Tenore Luigi, Regione Puglia
Terfili Cezarina, Scuola "B.Kadia" di Shkodra
Tibaldi Flavia, Istituto Italiano di Cultura di Tirana
Tritto Francesca, Liceo Linguistico "M.Polo" di Bari
Trungu Nadire, Infopoint Europa di Elbasan
Ugricic Sreten, Biblioteca Nazionale della Serbia
Vantaggiato Eugenia, Sovrintendenza Archivistica per la Puglia
Virgilio Francesco, Regione Puglia
Vorpsi Liliana, Arkivi Qëndror i Republikës së Shqipërisë
Xhamo Aleksandra, Biblioteca e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
Ylli Alketa, mediatore
Ymeri Petrit, Casa Editrice Dituria
Zfeher Zsolt, Junior Chamber International

SHTOJCA

REZULTATET FINANCIARE TE PROJEKTIT

Projekti BiblioDoc-Inn është aprovuar në fund të vitit 2003 me një financim fillestar prej € 463.875,00 me marrëveshje të nënshkruar midis Autoritetit të Drejtimit (Rajoni i Puglia-s) dhe Partner Leader më datë 9/12/2003 në kuadër të Programit PIC Interreg Itali-Shqipëri 2000-2007 mizura 4.1.1.

Gjatë realizimit të projektit është shtuar financimi nën dy profile:


1. në 2006 projektiti i është shtuar një shumë financiare prej € 150.000,00 me synim financimin e zgjerimit të aktiviteteve në zhvillim;
2. gjatë të njëjtit vit, projektiti i është shtuar një shumë e dytë financiare në lidhje me Mizura 4.1.2 e cila parashikonte realizimin e një aksioni të quajtur "Vlerësim i Kartave të Arkivit" si dhe hyrjen e partnerëve të tjerë italianë dhe shqiptarë për realizimin e këtij aktiviteti me një shumë prej € 250.000,00.

Të dy projektet, i pari origjinali, i bazuar në mizura 4.1.1, i zgjeruar për të mundësuar realizimin e aktiviteteve shtesë, dhe i dyti i bazuar në mizura 4.1.2 janë pjesë e të vetmes marrëveshje të Leader Partner me Rajonin e Puglia-s për një shumë totale prej € 837.875,00.

Aktivitetet e projektit dhe pagesat përkatëse janë kryer në mënyrë të rregullt.

Aktivitetet janë realizuar plotësisht dhe është shepnzuar 100% financimi i dhënë.

Ndarja e impenjimit financiar për aktivitete ka qënë si më poshtë:



Rendikontet e prezantuara Autoritetit të Drejtimit dhe të çertifikuara kanë patur një ecuri kryesisht konstante deri në muajin Tetor 2006; gjatë vitit 2007 janë realizuar aktivitetet e fundit të programuara dhe pagesat e të gjitha impenjimeve financiare të akorduara gjatë këtyre viteve. Gjatë projektit Partner Leader ka rendikontuar një mesatare prej € 120.000,00 për periudhë.

